

Zhvillim i strategjisë së misionit të kishës tuaj Cili është qëllimi ynë?

Të qënurit frikacak përbën shpeshherë një rrezik serioz për drejtuesit e Krishterë, veçanërisht kur i kërkojmë njerëzve tanë të ndërmarrin hapa të pa zakon të, të dalin jashtë zonës së tyre të rehatisë dhe që kërkojnë kurajo. Ndrojtja nga donjë raportim negativ në Media na shtyn ne të biem në grackën e frikës ndaj njeriut. Dhe është pikërisht kjo lloj frike, për të cilën Bibla na paralajmëron tek Fjalët e urta 29:25, që kthehet në kurth.

Por ne jemi shërbëtorë të Perëndisë së Gjallë. Ai është poçari dhe ne jemi argjila. Ne jemi kryqëzuar me Krishtin dhe nuk jemi më ne që jetojmë, por Krishti që jeton në ne. Si drejtues të kishës, neve na është dhënë përgjegjësia të drejtojmë dhe kujdesemi për tufën. Prandaj, na duhet të mendojmë qëllimisht sesi ti përgatisim njerëzit tanë të përmbushin Urdhërimin e Madh.

Misioni është një lëvizje gjithmonë në rritje, si në nivel lokal ashtu edhe global. Ai nis fillimisht në zemrat tona, përforcohet në pragjet tona dhe vazhdon deri në skajet e dheut.¹ Prandaj kërkohet si urtësi ashtu edhe qëndrueshmëri-vazhdimësi për të vendosur prioritetet e duhura në përfshirjen e kishës në mision. Prioritete të tilla si: arritja e një grupi të caktuar etnik apo njerëzve me nevoja specifike gjejnë reflektim si në nivel lokal ashtu edhe global.

Pse duhet ta bëjmë në këtë mënyrë?

Le t'ia nisim me disa supozime thelbësore:

- 1. Të menduarit dhe më pas të vepruarit në shkallë globale (për Ungjillin) nuk është fakultativ-opcion.** Mund të duket e çuditëshme por, shumë kisha shpenzojnë më shumë kohë në planifikimin e kohës shoqërore-kafesë, sesa në organizimin e fushatave ungjillizuese jashtë vendit. Kjo nuk do të përbënte ndonjë problem nëse Jezusi do të kishte thënë se, “Shpirti i Shenjtë do të na jepte fuqi për të qënë kafe-pirës në Jeruzalem, por jo në Jude, Samari dhe në skajet e dheut. Ndërsa neve na është

¹ Steve Timmis (ato fjalë , apo të tjera me të një jtin ndikim)

besuar një urdhërim global, të bëjmë dishepuj në Jeruzalem, Samari dhe në gjithë skajet e botës (Mateu 28:18-20; Veprat 1:8). Të bërit bisht do të thotë të mohosh autoritetin e Shkrimit.

2. Perëndia ka diçka specifike për kishën tuaj

Kjo e shpreh shumë qartë: “Ne në fakt jemi vepra e Tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to” (Efesianë rt 2:10). Thelbi i letrës së Efezianëve është të dëshmuarit të lavdisë së Ungjillit të unitetit, duke përfshirë shkatërrimin e mureve ndarës që shkaktojnë kryesisht paragjykimet ndër-etnike (2:14), dhe duke u demonstruar principatave dhe pushteteve në vendet qiellore, urtësinë e shumëllojshme të Perëndisë (3:10)- trupin e Krishtit që ndjek Kreun e tij (1:22-23).

3. Të shkuarit/dërguarit nuk vjen pasi “të ndërtojmë marrëdhënien tonë me Perëndinë më parë”.

Unë jam i bindur se të menduarit se, “Pasi të jemi rritur e forcuar si trup, atëherë Ai do të na përdorë për mision”, përbën një nga taktikat më të fuqishme të Armikut për ti mbajtur njerëzit e Perëndisë pasivë, ‘të ulur në stol’ ndërsa një botë e tërë po rrokulliset në ferr. Pa dyshim që ka elementë të vlefshëm në atë lloj mendimi. Megjithatë, edhe nga një vështrim i shpejtë i Veprave të Apostujve apo Letrave dallojmë qartë se, që në ditën e parë (menjëherë pas Rrëshajave) Perëndia po i përdorte apostujt, dhe kishat që ata mbollën, ashtu siç ishin, për të zgjeruar Mbretërinë e Perëndisë me anë të predikimit, mbjelljes së kishave dhe veprave të mira.

Por tashmë “ne jemi një fis i zgjedhur, priftëri mbretërore, një komb i shenjtë, një popull i fituar, që të shpallim mrekullitë e Atij që na thirri nga terri në dritën e tij të mrekullueshme” (1 e Pjetrit 2:9). Shkrimi na tregon se Perëndia na shpall ne të përshtatshëm dhe të gatshëm për të plotësuar qëllimin e Tij. Dhe na jep një urdhërim që lidhet ngushtë me identitetin tonë, të shpëtuar dhe populli i Tij i zgjedhur.

4. Strategjia globale është për të gjithë kishën, jo vetëm për disa ‘të thirrur’...

Po. Unë mendoj se thirrjet personale dhe specifike ekzistojnë (unë e zbulova thirrjen time gjatë kohës që punoja në një vend tjetër). Por, Perëndia njëkohësisht ia ka bërë të njohur thirrjen e Tij popullit të Tij, që në kohën kur Jezusi ishte në tokë. Ndoshta, ashtu siç kanë sygjeruar edhe të tjerë më parë, kishat duhet të pysesin, “Kush është thirrur për të

qëndruar?” Bindja jonë se, në zemër të misionit global qëndron kisha lokale, duke përfshirë edhe tonën, do të na drejtojë të dallojmë rolin që Perëndia ka për kishën tonë lokale.

5. ...pra, ‘përkushtimi i të gjithë kishës duhet dhe mund të bëhet qëllimi/objektivi

Ndërsa misioni është për të gjithë kishën, është roli i drejtuesve të krijojnë dhe ushqejnë një frymë misioni në kishë. Kisha duhet të krijojë një kulturë të menduarit që ka në thelb misionin- ku secili kupton qartë rolin që duhet të luaj.

Gruaja ime Odri (Audrey), po organizonte një konferencë për të mësuar gratë në Shqipëri. Megjithatë grave do t’u kërkohej të paguanin diçka, ne e dinim se, disa prej tyre nuk do të përballonte tarifat e hotelit (pa një ndihmesë financiare). Ne po luteshim ndërsa nuk e dinim se si do të siguroheshin këto financa. Ndërkohë Odri merr një email nga kisha jonë dërguese. Një çift që do të festonte përvjetorin e 50 dhjetë të martesës u kishte kërkuar të ftuarve që në vend të dhuratave të jepnin kundrejt konferencës së grave në Shqipëri. Ky çift e kishte kuptuar që Perëndia ka një rol për ty në misionin global edhe në moshën 90 vjeçare.

6. Vizioni nuk është e vetmja pasuri.

Duhet mbajtur mend se: vizioni nuk duhet pritur nga ‘vizionarët’ me tituj apo përgjegjësi (zyra apo iPads). Perëndia mund dhe ua ka dhënë vizionin e Tij njerëzve të thjeshtë dhe besnik. Një drejtues i urtë/ zgjuar është ai që e kupton rolin e tij (aq më tepër në një skuadër) në dallimin dhe mbledhjen e vizionit kudo që ai lind në kishë. Lutu, dëgjo, mëso dhe mblidh ide-mendime. Inkurajoi dhe mbështeti hapur ata që ti dhanë. Do të vëresh se njerëzit do të entuziazmohen nga i gjithë ky proces. Madje ata do të jenë të gatshëm edhe të sakrifikojnë për visionin ‘tënd’.

Hidhi një sy kapitullit të ardhshëm: ‘Identifikimi i skuadrës së misionit’

Nga duhet tia nisim?

Zgjidh një strategji. Cilëndo!

Gjëja e rëndësishme, (ndonëse jo gjithmonë e dukshme) rreth strategjisë së misionit global është të kesh një strategji. Ashtu si apostulli Pal pati një vizion të madh (të çuarit e Ungjillit tek Paganët) e ndihmoi në qasjen e tij, po ashtu edhe tabloja e plotë e vizionit të Perëndisë për kishën tuaj do të ushqejë dhe skalitë kriteret tuaja në formimin /zhvillimin e strategjisë ekzistuese apo të partneriteteve të reja të misionit.

Proçesi i zhvillimit të strategjisë së misionit të kishës tuaj do të përfshijë specifikisht dhe qëllimisht çështje të tilla si:

- Cili është roli i kishës dhe i misionit
- Cili është lajmi i mirë i Mbretërisë së Perëndisë (për një grup të caktuar njerëzish apo situatash)?

Për disa kisha kjo do të thotë: të përdorin fillimisht si trampolinë vizionin ekzistues në nivel lokalë për të themeluar një strategji për përfshirjen globale. A është kisha juaj e përkushtuar- apasionuar ndaj predikimit? Ndoshta kjo mund t'ju ndihmojë për tu shërbyer mësuesve të Biblës në vende të tjera. A ka ndonjë grup-etni të caktuar njerëzish në komunitetin tuaj apo atë studentor? Mendoni rreth asaj se si mund tu shërbeni këtyre njerëzve, si këtu apo edhe në vendin e tyre, si ambasadorë të Krishtit!

Ndërsa për të tjerët, të menduarit rreth një strategjie për misionin global mund të ndihmojë në skalitjen e prioriteteve dhe fokusit të tyre në nivel lokal. Kjo nënkupton të dalluarit-përcaktuarit brenda bashkëpunimit misionar të prioriteteve dhe zonave ekzistuese të shërbesës. Apo ndoshta ky është momenti kur ju duhet të nisni vlerësimin mbi vendndodhjen, dhuntitë apo përgatitjen e kishës tuaj për të arritur botën me Ungjillin e Krishtit.

Radstock ofron Konsultime-këshillime në lidhje me Misionin për drejtuesit e Kishës, anëtarët e komitetit-skuadrës së misionit apo për të gjithë trupit të Krishtit.

Hidhi një sy kapitullit të ardhshëm: 'Auditimi i kishës tuaj për mision'

- Shpeshherë mënyra më e mirë për të kuptuar se ç'farë duhet bërë është thjesht të bësh diçka,
- Provo disa apo edhe të gjithë hapat
- Investo në trashëgimi-ç'farë po bën Perëndia në mendjet dhe zemrat e njerëzve? Mos ngurro të ndërtosh mbi këtë!
- Tregohu një oportunist agresiv- dallo mundësinë që shfaqet dhe merre. Jepet falas.
- Shfrytëzo marrëdhëniet e tua- kë njeh? Si mund të jenë ata të dobishëm për ty dhe anasjelltas? Kërko!
- Parashiko të dështosh- Mos u dekurajo nga dështimet!
- Ji i guximshëm- Nëse skuadra e gjërave rutinë aprovon atë ç'farë po bën atëherë ka ardhur koha të guxosh.

Fokusohu!

Pasi të kesh adoptuar strategjinë, qëndroji besnik. Vendos disa parametra në lidhje me atë ç'farë misioni juaj global duhet të plotësojë dhe më pas përdori si filtrues për të gjithë

Dikur dëgjova një pastor të një kisha të vogël fshati të përshkruaj sesi kisha e tij kishte ndihmuar në kishë-mbjellje në një qytet të Azisë Qëndrore- një vend mjaft i vështirë për mision. Ai tregoi sesi në këtë lëvizje krahas kishës së tij kishin kontribuar edhe kisha të tjera apo biznese lokale. Unë e pyeta për 'sekretin e tij'. "Këmbëngul në mbrojtjen e vizionit tënd." Ai e kishte kuptuar se kisha e tij nuk mund të prekte të gjithë botën me Ungjillin e Krishtit. Kështu që u fokusuan në një qytet të vetëm.

Në anën tjetër, një kishë e madhe dhe mjaft aktive kërkonte një person, që do të merrte përsipër formimin e një strategjie për misionin. Një nga drejtuesit shpjegon, "Ne kemi dërguar 25 misionarë në të gjithë botën. Të gjithë kanë mbështetjen e plotë financiare të kishës. Megjithatë, ne nuk e dimë se ç'farë po ndodh!" Ata e kishin kuptuar mjaft mirë se po vuanin nga mungesa e një strategjie dhe jo e fondeve apo njerëzve.

Në të shumtën e rasteve, një strategji e qëllimshme do të ndikojë pozitivisht në përkushtimin ndaj misionit global, duke u fokusuar në themelimin e një numri më të vogël por njëkohësisht përkushtimeve më serioze.

Paralajmërim! Kjo mund të shkaktojë kritika. Por frika nga kritikrat apo implikimet mund të përbëjë rrezikun- pengesën më të madhe, qoftë për individë apo edhe për kishën, në implementimin e strategjisë së misionit global.

Hidhi një sy gjithashtu “Cilat janë problemet me të cilat mund të ndeshemi...” kapitulli në vazhdim

Harroje strategjinë! (Be non-strategic)

Tim Chester thekson se strategjisë i është kushtuar më tepër vëmendje nga çduhet. Shpirti i Shenjtë është në fakt “strategjist i më i mrekullueshëm i misionit”². Fakti se ne jemi bashkëpunëtorë me Perëndinë na thërret të jemi të hapur ndaj ‘mundësive’ për të ndjekur Shpirtin e Shenjtë (Filipi në Veprat 8) sepse është Ai që përmbush dhe kontrollon strategjitë tona. Le të kujtojmë se, ky është në rradhë të parë vizioni dhe misioni i Perëndisë para së të jetë yni!

Identifiko se cilët janë njerëzit me dhunti apostolike brenda kishës tuaj dhe njëkohësisht besojë atyre eksplorimin e mundësive të reja! Nëse mendon se kisha juaj nuk ka kapacitete të tilla, atëherë drejtoju kishave të tjera bashkëpunëtoresh që janë më të kompletuara. Por sigurisht që, Perëndia ka vendosur njerëz të tillë edhe në kishën tuaj (vë re; shpesh këta paraqiten si tepër aktivë, nganjëherë të bezdisshëm apo edhe arrogantë- kur janë të rinj. Por, nëse investon në jetën e tyre, në kohë dhe trajnim- ata kanë për të të befasuar).

Pas të kesh krijuar idetë e qarta mbi strategjinë dhe me gadishmërinë për të qenë i hapur ndaj ndryshimeve, lutu dhe ëndërro ëndrra! Merr hapa me besim ndërsa e lejon Shpirtin e Shenjtë të të drejtojë ty dhe kishën në arritjen e botës me Ungjillin a Jezus Krishtit. Kupto që roli yt është të drejtosh dhe mobilizosh njerëzit që të janë besuar për të përmbushur Urdhërimin e Madh.

² Konferenca e Radstock- viti 2009

Rast-studimi: Kisha Baptiste Stopsley (KBS) në Luton të MB.

Ndërsa Brajan Xhozes iu ngarkua roli të ndërtonit strategjinë globale të misionit për KBS, ai u këshillua me njerëz të interesuar, disa prej të cilëve vinin me opinione të forta, disa me ide të qarta, dhe të tjerët pa ide, por me një zemër të gatshme për të shërbyer.

Si rezultat i takimeve të tilla të hapura, u formua një grup i vogël i përbërë nga bashkimi i 'bletëve punëtore' dhe ideve të mëdha. Skuadra filloi menjëherë të lutet si për ide afat-gjata ashtu edhe mundësi misioni afat-shkurtra.

Ishte koha e Perëndisë. Menjëherë pas kësaj kriza në Kosovë mbuloi shtypin botëror. Kisha filloi të ndërgjegjësohet për rolin e saj në gjithë këtë situatë. Duke shfrytëzuar edhe marrëdhëniën ekzistuese me drejtuesit e kishave në Kosovë dhe Shqipëri, u përfshirë aktivisht përkrah Kishës në Ballkan për t'u përgjigjur nevojave imediate.

Nëpërmjet kësaj mundësie afat-shkurtër, marrëdhënie strategjike dolën në dritë duke hedhur themelin për një bashkëpunim fat-gjatë. KBS e dinte se kjo ishte koha e duhur për të mbështetur kishën Shqiptare.

Prej këtu KBS vendosi të fokusohet në tre prioritete bazë:

- ti shërbejë të varfërve
- të mbjellë kisha aty ku njerëzit nuk janë arritur me Ungjillin
- të përgatisë drejtues misioni për kishën

Qëllimi është të bashkëpunohet aty ku të paktën dy nga prioritetet e mësipërme janë të përfshira. Siç përmend edhe Brian, "Bob Geldof mund tu shërbejë të varfërvë më mirë se ne, por ai nuk po mbjell kisha (ndan Ungjillin)!"

Në vazhdim KBS vendosi të lërë mënjanë disa prej projekteve të mëparshme dhe të mbajë fokusin e duhur. Faktorët që ndikuan në përcaktimin e një fokusi afat-gjatë për të ardhmen ishin: marrëdhëniet e vjetra, lidhjet në nivelin lokal-global që premtinin një bashkëpunim afat-gjatë si dhe interesi në rritje brenda kishës.

Me qëllim që të eksploroheshin mundësi të reja u ndërmorrën disa iniciativa dhe fushata afat-shkurtra. Pjesë e këtyre skuadrave, fushatave afat-shkurtra u bënë edhe Pleqtë dhe atëtarë të skuadrës së Misionit Global të kishës, me qëllim që kisha të fitonte një tablo më të qartë për të ardhmen e misionit.

Nga vizioni në realitet

Pasi të kesh ndërtuar strategjinë, hapi i dytë që duhet hedhur, si për fushatat afat-shkurtra ashtu edhe për misionin afat-gjatë, është ta vësh atë në praktikë,

Së bashku me skuadrën, shtroni pyetjet:

- Ç'farë kërkojmë të shohim që Perëndia të bëjë nëpërmjet nesh në tre vitet e ardhshëm?
- Ndaje me njerëzit se ç'farë mendon që Perëndia kërkon prej kishës tuaj
- Vendos disa objektiva që do t'ju ndihmojnë në arritjen e visionit tuaj
- Jini të përgatitur për dështim, dhe lutuni pa rreshtur!

Kini parasysh që zbatimi i strategjisë suaj do të kalojë nëpër 'stinë' të ndryshme. Në hapat e para të zhvillimit është e rëndësishme të tregohet- komunikohet një frymë eksplorimi (të hapur dhe fleksibël ndaj të pa priturve)! Inkurajo njerëzit të përfshihen me entuziazëm në projektet, fushatat- udhëtimet apo diskutimet fillestare. Ndërkohë, mundohu të dallosh se cilët prej tyre premtojnë për të drejtuar apo u përfshirë në projekte- marrëdhënie afat-gjatë.

Gjithashtu duhet mbajtur mend se fushatat-skuadrat afat-shkurtra do të ndihmojnë mjaft mirë në zhvillimin e marrëdhënieve apo iniciativave afat-gjata. Kështu, mund të dërgohet një skuadër nga kisha juaj për të ndihmuar një kishë bashkëpunuese në një vend tjetër me kampin e fëmijëve. Marrëdhëniet afat-gjata janë djepi në të cilin tunden programe që ushqejnë misionin dhe dishepullizimin e të dyja/ gjithë kishave.

Cilat janë problemet e mundshme (dhe si mund ti mënjanojmë ato)?

Ta mbajmë strategjinë të freskët- aktuale

Bota është e mbushur me 'monumente' në formën e organizatave dhe iniciativave dikur risi por që kanë humbur tashmë entuziazmin dhe efektivitetin. Vizioni fillon e zbehet dhe me kohë humbet kontaktin me realitetin gjithmonë në ndryshim.

Pra, tregohu i qëllimshëm në bërjen e një analize/vlerisimi vjetor, dhe të një rishikimi të përgjithshëm të vizionit rreth çdo tre vjet. Me shumë gjasa do të dallosh se disa prej gjërave janë akoma të vlefshme, disa të tjera duhen rinovuar dhe teprica, pasi kemi nxjerrë mësim prej tyre, duhen flakur tutje. Ti japësh fund diçkaje-një praktike, sigurisht që do të shkaktojë pakënaqësi tek dikush. Nëse ky je ti, atëherë kërkohet shumë përukje. Nëse ka të bëjë me një vëlla apo motër, atëherë kërkohet shumë ndjeshmëri, qartësi dhe kurajo për të përballuar kundërshtimin apo zhgënjimin.

- Rishikoni dhe rinovoni: Ç'farë funksionon dhe ç'farë jo? Ftoni një të jashtëm (kishë apo skuadër tjetër) për t'ju ndihmuar të dalloni-rishikoni qartë. Kështu që mund të jeni të përfshirë aktivisht në diskutime, pa u shqetësuar për formatin.
- Merrni në konsideratë ide të reja: Kjo do t'ju ndihmojë në konsolidimin e përkushtimit tuaj dhe do ta mbajë fokusin tuaj tek Perëndia. Jini të ndjeshëm- të hapur ndaj asaj që ndodh përreth. Ndoshta ka ardhur koha për një eksplorimim të ri.
- Mbajni sytë hapur- mat temperaturën e skuadrës: Ndoshta është momenti për të rifreskuar skuadrën.
- Ki besim tek skuadra jote: Ata (zakonisht) e kryejnë këtë shërbesë falas apo edhe duke sakrifikuar nga jeta e tyre. Janë ata që luten dhe kujdesen. Mëso prej tyre dhe mbështetu tek ata.
- Zbato Efezianët 4: është detyra jote të vësh në veprim dhuntitë që të janë besuar, qoftë atë të apostullit, profetit, pastorit, mësuesit apo ungjëlitarit, për të ndërtuar njerëzit që të janë besuar dhe përgatitur për shërbesë. Ti përgatit, ata shërbejnë. Kështu shërbejmë së bashku!

‘Fut një krap në çisternë’

është vërejtur se gjatë kohës së transportit në distanca të largëta brenda në çisternë troftat bien në gjumë dhe humbasin shijen e tyre kur serviren te gatuar. Dikush zbuloi se prania e një krapit në çisternë shkaktonte nervozitet dhe si pasojë i mbante troftat aktive...

Prandaj, merr persona në skuadrën tënde, vizioni dhe zelli i të cilëve të tremb. Ndoshta ata janë zëri i Perëndisë për ty.

Kur njerëzit e mirë paraqesin ide që janë jashtë vizionit të kishës tuaj

Kur një besimtar i përkushtuar ju tregon se dëshiron të shërbejë mes fëmijëve të rrugës në Brazil, ndërkohë që fokusi i kishës suaj është përkushtimi ndaj të varfërve në Azi, lind dilema- si mund ti themi 'Jo'? Sigurisht që ekziston mundësia që Perëndia të jetë duke ju folur për të nisur dicka të re si kishë. Megjithatë, njerëzit shprehin ide apo dëshira që shpeshherë janë sa të singërta po aq edhe të përgjithshme/jo konkrete.

Si drejtues i kishës ti duhet ti ndihmosh njerëzit e tu të dallojnë nëse, në një farë mënyre, po shpallin planin e Perëndisë si pjesë të përkushtimit ekzistues të kishës tuaj. Për të tjerët, është e rëndësishme ti lënë njerëzit të shkojnë me bekimin e kishës, duke inkurajuar të gjithë të përfshihen në mënyrë aktive në zbatimin e Urdhërimit të Madh, ndërsa pranojmë njëkohësisht se, këto janë vetëm disa nga mundësitë- shërbesat të cilat kisha mund të mbështet.

Ja disa nga alternativat që kishat përdorin:

- Lejo njerëzit të krijojnë një grup brenda kishës që në mënyrë të pavarur të rekrutojnë bashkëpunëtorë, financa etj. Nëse kjo ka zgjatur për mëse dy vjet, atëherë bëje pjesë të strategjisë suaj (duke i ndarë edhe buxhetin përkatës).
- Thjesht thuaj 'jo' (ndërsa kërkon ta përfshish personin në vizionin dhe thirrjen e kishës).
- Konsidero ta dërgosh personin- mundësisht në grup/së bashku me të tjerë, për të parë nëse Perëndia është duke e drejtuar kishën tuaj në hapësira të reja shërbimi (kujto, vizioni nuk është asnjëherë nga lart-poshtë).
- Siguro kategori të ndryshme punëtorësh dhe përcakto përkatësisht nivelin e mbështetjes dhe të profilit publik.
- Bëje iniciativën pjesë të programit të kishës tuaj për të bërë dishepuj, duke e lejuar në të njëjtën kohë iniciativën të rritet brenda këtij konteksti.

Skuadra e të rinjve tanë ka krijuar dhë përforcuar lidhje në Filipine. Gjithçka nisi nga një fushatë misioni afat-shkurtër. Por që me kalimin e kohës është rritur dhe ka përfshirë të gjithë kishën. Fillimisht janë ftuar Filipinasit në kishën tonë të shërbejnë në MB, dhe më

pas kemi dërguar një grup 'të rriturish' ish anëtarë të grupit të të rinjve të shërbejnë në Filipine për rreth dy vjet.

Marrëdhënia me Organizatat (Relationships with Agencies)

Shpeshherë theksi i Radstock-ut se, kisha është zgjedhur për të qenë në qendër të misionit (dhe anasjelltas) është keqinterpretuar si një lloj paragjykimi ndaj organizatave misionare. Në fakt ë shtë krejt ndryshe. Bindja jonë është se, nëse Perëndia ka vendosur kishën në zemër të misionit dhe misionin në zemër të kishës, atëherë Ai nuk është i interesuar në misionin pasiv apo të deleguar. Prandaj, në çdo bashkëpunim të mundshëm në lidhje me misionin fokusohu tek:

- Kultivimi i një përkushtimi të të gjithë kishës në mision, duke inkurajuar secilin të kontribuojë, në mënyra të ndryshme, sipas dhuntive përkatëse, kohës apo burimeve të tjera.
- Zhvillimi i një bashkëpunimi të ndërsjellë me kisha dhe misionarë, i cili do të sjellë ndikim dhe përfundim të dyanshëm mbi kishën dhe misionin global.

Disa organizata janë më të gatshme për tu përfshirë në këtë lloj bashkëpunimi. Ndërsa në njëra anë takojmë kisha që mbeten si të 'paralizuara' para një interesi të vazhdueshëm të organizatave misionare. Në ekstrem tjetër gjen kisha që përballen me organizata të mbushura me 'ekspertë' - të pavaruar nga kishat lokale (qoftë dërguese apo pritëse). Por ajo që duhet të kujtojmë është se: ekspertët nuk janë misionarët por besimtarët vendas.

Për më tepër, edhe organizatat më tradicionale mund të jenë shumë të hapura apo edhe të fitohen nga një këmbëngulje e qëllimshme për komunikim dhe bashkëpunim. Kur isha ende një pastor i ri për misionin lokal-global në kishën time, dëgjova një organizatë të thoshte, "na jepni paratë dhe njerëzit tuaj dhe ne do të bëjmë punën". Përgjigja jonë ishte negative- Ne nuk pranuan. Ndërkohë, një organizatë me një ekperiencë të gjatë në mision, që në fillim dukej e pa depërtueshme, na u drejtuan më pas për të kërkuar bashkëpunimin tonë në lidhje me organizimin e një aktiviteti kombëtar.

Si në çdo lloj bashkëpunimi, ndërtimi i marrëdhënieve të besueshme kërkon kohë dhe gadishmëri, dëshirë për të dalluar dhe rrjedhimisht përcaktuar rolet përkatëse të të dyja palëve (kishë dhe organizatë). Fokusi duhet të jetë në atë se çfarë i shërben Ungjillit

në frontin e parë . Dhe thelbi nuk qëndron në pranimin apo jo të organizatave, por në përfshirjen dhe përkushtimin e plotë të kishës në mision.